



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 90/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hasan Shala, kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën-ankesë e Rrahim Elshani nga fshati Baicë, Komuna e Glllogocit, në cilësinë e kandidatit të pavarur për Kryetar të Komunës në Glllogoc, për zgjedhjet lokale të jashtëzakonshme te datës 04.12.2016, lidhur me tërheqjen nga lista si kandidat për Kryetar të Komunës në Glllogoc, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.11.2016, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET kërkesa-ankesa e Rrahim Elshani nga fshati Baicë, Komuna e Glllogocit, në cilësinë e kandidatit të pavarur për Kryetar të Komunës në Glllogocit, me të cilën ka kërkuar të tërhiqet nga gara për kryetar të Komunës në Glllogoc, për zgjedhjet lokale të jashtëzakonshme, te datës 04.12.2016, **si e palejueshme.**

A r s y e t i m

Me datën 18.11.2016, PZAP-i ka pranuar kërkesë-ankesë nga Rrahim Elshani nga fshati Baicë nga Komuna e Glllogocit, në cilësinë e kandidatit të pavarur për Kryetar të Komunës në Glllogoc, për zgjedhjet lokale jashtëzakonshme te datës 04.12.2016, me të cilën ka kërkuar të tërhiqet nga gara për kryetar të Komunës në Glllogoc, për zgjedhjet lokale të jashtëzakonshme, te datës 04.12.2016.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj kërkesën-ankesën e parashtruesit, gjeti se e njëjta është e **palejuar**, për këto arsye:

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me dispozitën ligjore të nenit me nenin 28 par.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), e cila dispozitë ligjore është e vlefshme edhe për zgjedhjet Lokale, në të cilën parashihet se subjekti politik i certifikuar respektivisht kandidati i pavarur, mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit.

KQZ-ja, me datën 18.11.2016, e ka hedhur shortin për renditjen e subjekteve politike respektivisht kandidatëve për kryetar të Komunës në Zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në Gillogoc, të datës 04.12.2016. Në rastin konkret pala e cila ka parashtruar kërkesë-ankesë në PZAP, nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e kërkesës për tërheqje nga gara KQZ-së, sipas dispozitës ligjore të nenit 28.5 të LZP-së. Me qenë se pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e lartcekur për tërheqje nga lista e kandidatëve, por ka parashtruar drejtpërdrejt kërkesë-ankesë në PZAP, gjë që nuk është e lejuar sipas LZP-së.

Nisur nga të gjitha arsyet e theksuar më lart, PZAP-i, vendosi se kërkesa-ankesa, është e palejuar andaj duke u bazuar në nenin 6 par. 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe 118 par. 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 90/2016 më datën 18.11.2016.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në kuptim të dispozitës ligjore, të nenit 118.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes së vendimit-pranimi.